



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 35

Datë: 03. 07. 2017, ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Ergit Qeli, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyesë: Vera Dula

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.**
 - 2. Njoftim lidhur me vendimet e PZAP-it.**
 - 3. Të ndryshme.**
-

1. Hyrje: Kryesues i mbledhjes, z. Ergit Qeli, anëtar i KQZ-së

Ergit Qeli: Pershendetje të gjithëve antarë të nderuar. Unë, me autorizim të kryetares do ta kryesoj mbledhjen e 35 - të këtij viti. Besoj, secili nga ju i keni pikat e rendit të ditës dhe materialin e nevojshëm para se ta hudhim në votim rendit e ditës. A ka dikush ndonjë sygjerim apo vërejtje rreth rendit të ditës...?

Betim Gjoshi: Unë, kam me i diskutuar realisht sot, jo për rend të ditës por, kërkoj që me një mbledhje të parë me u përgatitë vendimi për ndarjen e fondit për subjekte politike në ditën që i çertifikojmë rezultatet për funksionim të subjekteve politike dhe grupeve parlamentare që e kemi detyrim ligjor se, vetëm sa kemi hyrë në 3 mujorin e tretë...Mandej, u bënë 2 javë që kur kanë mbaruar zgjedhjet dhe kërkoj sa me parë me u sjell plani i buxhetit për miratim për këto zgjedhje edhe plani i punësimeve për këto zgjedhje, mandej kërkoj edhe nga mediat për raportin e auditorit nuk e kemi par para vetit kërkoj sa ma shpejt me u sjell në komision zgjedhor në komitet të auditimit edhe gjithashtu të përgatitemi për mësimet e nxanuma nga këto zgjedhje...

Ergit Qeli: Kush është për rendin e ditës...?

Anëtarët e KQZ –së, miratuan rendin e ditës në mënyrë unanime, pa ndonjë vërejtje apo sygjërim...

1. Njoftim lidhur me vendimet e PZAP-it

Betim Gjoshi: Unë, i kam pa vendimet edhe pse kohë e shkurt kam arritur që t'i lexoj edhe të aprovuar edhe të anuluar...Sa i përketë dispozitivit, unë edhe këtu mendoj se i shërbejnë se vota e votuesve me shkuar në vendin e njëjtë...Ka shumë prej tyre kutive që ne i kemi numri pjesërisht, po ta kishim marr një vendim ma te përgjegjshëm me kaluar apo siq e kemi propozuar edhe një pjesë të anëtareve këtu at herë do të përjashtohet nga numri nje pjes e madhe e këtyre do te ishin tash me vota te vendosur ne vendin e duhur një pjesë e madhe janë për shkak te gabimeve njerëzore unë çka deshta me theksuar se njëra prej këtyre vendimeve njeri ka te bej me anulimeve te 77 fletvotimeve me kush edhe pjesa tjetër e vendimeve kanë të bëjnë me rinumërimin e 166 kutive të votimit pjesërisht d.m.th., prapë janë vendimet por janë edhe disa raste ndoshta kanë qen gabime terminologjike disa thuhën kandidat të disa subjekteve politike dhe ndërsa disa thuhet për kandidatit e subjektit X unë mendoj se në këto raste kur kandidati osht e pa mundur për shkak të procedurave se mundet të kemi disa mos përputhje...

Unë, tha z. Gjoshi, mendoj se ne rinumërim se një kandidati ose një subjketi rinumërohen të gjitha kandidatëve të atij subjketi se për ndryshe edhe teknikisht edhe proceduralisht është e pa mundur për gjithë ne që e dimë do të kemi mos barazim te votave kandidat edhe nuk i pranoj edhe vetvetiu sistemi që na duhet të miremi me rinumërim edhe një here pra unë kisha kërku se qendra e numrimit ne procedurë sa ma te shpejt bazuar ne procedurat e tyre te filloj rinumërimin njoftoj vëzhgus e partive te tyre politike dhe mediat që të jen aty pran në qendrën e numërimit të edhe të filloj me procedurën duke u bazuar edhe me koleget që edhe të tjerë me mbeshtesin se nuk ka rrugë tejte ligjore që ne pjesën se ku është e shkruar ne rregull ku thuhën kandidat ku është njësi kandidati ku është e pa mundur të rinomrohen votat e gjithë kandidatëve...

Adnan Rrustemi: Faleminderit kryesues...! Është e vërtet se, ne nuk kemi rrugë tjetër për veç se ti zbatojmë vendimet e ZAPIT do të fillojmë rinomrimet sa më parë dhe rinomrimet e pjesshme të votave të kandidatëve të subjekteve politike në cilat i ka përcaktuar PZAPI që duhet të rinumërohen e mira e kësaj pune është duhet të kemi rinumërim të pjesshëm vetëm për votat e kandidatëve të subjektet politik në fjalë për secilin vend votim kjo të paktën do ta lehtësoj procesin e rinumërimit që të jemi sa ma shpejt brenda kësaj situate që u bë pak në kuptimin publik edhe e pa durueshme te vonimit të shpalljeve dhe të certifikim e rezultateve përfundimtare. Pajtohem se, sa më parë që të kemi një plan të operimit me rinomrimin e këtyre kutive që ti hapim rrugë certifikimit me gjithë at duhet ta them se ky aspekti i numërimit dhe i ri numërimit të kutive që vjen si rezultat qoftë i gabimeve të pa qëllimshme qoftë ndërhyrjeve të qëllimshme në vendvotim, është bërë një aspekt jashtë zakonisht shqetësues i procesit zgjedhor.

Nuk mundet që t'i tolerojmë ne vazhdimësi të përsëriten nga 400 deri 500 kuti te rinomëruara për shkak të trajnimit të dobët, diku për shkak të lodhjeve të komisionarëve, diku për shkak të ndërhyrjesh se qëllimshme etj. KQZ mendoj se duhet ta ketë shumë prioritet këtë aspekt duhet të nxjerrim mësim në fakt po përsëritet por nuk është që po adresohet që mos të kemi kuti që na vijjnë për rinumërim si rezultat i mos kryerjes se punës në këshillat e vendvotimeve shpresoj se QNR te operoj me kapacitet të plota dhe që ti përmbyll sa ma shpejt mbase mund të na jep edhe një informacion se kur mund të filloj dhe kur mund ti përmbyll këto kërkesa aktuale...

Betim Gjoshi: Pavarësisht, nëse me lejoni na nuk është se nuk kemi pas mësim për këtë çështje të rinumërimeve ose pa numrimin të saktë vota për kandidatë për këtë arsye ja rikujtojmë për nja 4 mbledhje kemi diskutuar si Komision Qendror Zgjedhor edhe shumica ndoshta gjithë kemi qen për me i marr disa masa ndaj procesit përgjegjësi përfshirë edhe ato masa stilumative por edhe ndëshkues ndaj komisionerëve por, edhe po t'i kishim marr si të tilla mendoj se në masë të madhe ish zvogëluar numri i rasteve të numërimit...Mendoj se, i mbetet shumë Kuvendit të Kosovës me një reformë zgjedhore që do ta kish përshtatur ose te fusë makina numëruar elektronike ose te gjej mënyra tjera qe ta bëj sa ma të saktë numërimin e votave për subjekte politike edhe për kandidat se për një mend ndoshta edhe për 1 votë ta numërojmë një kuti kjo është e pa arsyeshme, do të thotë edhe nuk ja kemi borxh tek e fundit votuesit që kanë dal e kanë kryer obligimin e vet.

Eshref Vishi: Faleminderit kryesues, unë mendoj se dispoziteti i vendimeve te PZAP –it, është mjaft i qartë, mandej disa vendime për numërimin apo rinumërimeve të votave me një kuti për kandidatë dhe vendime tjera për kandidatë. Unë mendoj, tha z. Vishi se, vendimet e PZAP-së, duhen të zbatohen ashtu siç janë në diapozitiv...Unë, megjithë mendoj se si Komision Zgjedhor, nuk kemi të drejtë të referohemi në dispozitave në vendimet e PZAP-së...Pajtohem me ata që u përmendet ma herët...Nuk e di sa është e vështirë se KQZ t'i bëjë rinumërimin e votave për kandidatët...

Sami Hamiti: Megjithatë, propozimi apo çështja se si duhet të bëhet rinumërimi ata që e propozoj Betimi, ajo është e rregullta s'mundesh me thanë ti se një kandidati me ja numërua votat...Ndërsa, ato vota janë bartë tek një kandidatë tjetër në momentin e fundit kur të rinumërohen se, atje ka pa barazim në kuti, herën tjetër e latë vetëm kur kërkova që të rinumërohen

komplet...Dikush absteno, mirëpo unë votova kundër në kuptimin që të rinumërohen të gjitha edhe në këtë rast, vendimi i PZAP-së është për një kandidatë...Po themi mirë, se një shumicë e tyre kandidatëve që e pash unë, janë bere kërkesa se votat e tyre janë bartë me një kolonë tjetër dhe këto e kenë problemin në momentin që t'i barazoni në kuti finale prandaj, duhet të numërohen të gjitha...

Adnan Rrustemi: Jo, ajo që dua të them dhe ta kemi të qartë është se bëhet fjalë për rinumërimin e votave të subjektit në fjalë të kandidatëve tek I cili ka mos përputhje ose ka mungesë ose bartje të gabime ose të qëllimshme të votave d.m.th., nuk bëhet fjalë për rinumërim të tërësisht të kutisë dhe të secilit subjekte politik dhe për secilin kandidatë bëhet fjalë për subjektin në fjalë dhe po pajtona se me siguri është gabim teknik tek ato vendime që bëhet fjalë vetëm për një kandidatë...Është e pa mundur për të ardhë me një përfundim në përputhje nëse nuk numërohet të gjitha votat të gjithë kandidatëve në at kuti të atij subjekti politik se diku ato vota janë vendosur gabimisht edhe nuk mundemi me ju lejuar atij gabim dhe atij tjetri për me u rinumëru edhe një here sepse kemi ripërsëritje të gabimit në formë tjetër...Kështu që, kjo është e domosdoshme por me u qartësuar, është se le të përdoret për kufizimi që i ka dhënë në këto vendime në shumicën e vendimeve që është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të rinumëroj fletëvotimet vetëm për kandidatët për deputet nga koalicioni ose partia në fjalë pika pika pa e përmendë...

Binak Vishaj: Ne, i respektojmë vendimet e PZAP-së ashtu qysh ata e kanë vendosë...Ne, do t'i respektojmë sepse, ne kemi bërë rinumërim të votave për kandidatët edhe në këtë procesin e ma hershem duke i pasur parasysh 116 kuti...Kisha pas dëshirë me ndëgjuar prej koordinatorit të QNR-së se, kur do të filloj rinumërimi i këtyre kutive se, sa do të zgjasë dhe me çfarë kapacitet do të rinumërohet...Besoj se kjo është me rëndësi për media dhe për opinionin se sa do të zgjasë ky rinumërimi, dhe kur do të fillojë le të ftohen subjektet politike, vëzhguesit ndërkombëtarë dhe gjithë ata që janë të interesuar që ta vëzhgojnë këtë proces të rinumërimit, ndërsa vendimet e Panelit Zgjedhor, na të gjithë i kemi respektuar dhe kjo traditë do të vazhdojë...

Enis Halimi: QNR ka bërë të gjitha përgatitjet teknike për të filluar sa ma shpejt sot në orën 4 të procesit të numërimit përkatësisht të rinumërimit të tyre sipas vendimeve të PZAP-së, dhe vendimeve të KQZ-së sepse, është një procedurë relativisht standarde janë njoftuar edhe përfaqësuesit e partive politike edhe vëzhguesit e tjerë pra është proces standard sikur se ka qenë për rinumërim të kutive të tjera, pra janë gjitha përgatitjet do të fillohet në ora 16 besoj që mbrenda një ndërrimi do të mundohemi me kapacitet të plota se dhe që ato do të përfundojnë...

Betim Gjoshi: Jo, ndoshta vetëm edhe nja dy rreshta, nëqoftëse e shihni në vendime që obligimet për rinumërim në këtë rast edhe për një anulim për Komisionin Qendror Zgjedhor sjell edhe disa obligime tjerë a që janë ndalimi i pjesëmarrjes për disa persona është mirë që edhe në at pjesë të kujdesemi ne edhe të futemi në databazë që mos a na përsëriten as mos komisione komunale zgjedhore e as për këshilla të vendvotimit për këto zgjedhje. Unë, kam pas një rast që është zgjedhjet e tri herë i njëjti kryeses, i njëjti kandidatë që nuk ja ua qetë votat, i qetë 0 edhe tri herë merr pjesë në rinumërim...

Unë, tha z. Gjoshi, ju them se ky rast ka ndodh në komunën e Ferizajt...Propozoj që të urdhërohet Qendra e Rinumërimit të Rezultateve t'i numëroj fletëvotimet për kandidatë e subjektit, që janë në fjalë që kanë të bëjnë me fletëvotime...Janë disa raste, sepse edhe PZAP ka bërë gabim në terminologjinë e subjekteve "Fikrim Daka" prej koalicionit LKD-AKR, i tapon një subjekti tjetër...Ose, një rast 68 vota ju kanë bart, e tjerat janë rinumëru...

Adnan Rrustemi: Unë, kisha dashtë një raport të veçantë nga QNR-ja për gjendjen që delë nga numrimi, sidoms për përputhjen eventuale...

Në këtë pikë, diskutuan më tej" Adnan Rrustemi, Betim Gjoshi, Binak Vishaj. Në fund, z. Betim Gjoshi, propozoi një draft – urdhëresë lidhur me QNR-në që të fillojë operacionin e rinumërimit. Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimet e PZAP-së.

2. Këshillat e KQZ-së

Raporti i Këshillit për Operacione Zgjedhore

Adnan Rrustemi: Këshilli i Operacioneve Zgjedhore në mbledhjen e sotshme në përputhen me planin operacional dhe vendimin për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017, ka shqyrtuar nominimet për përmbajtjen e komisioneve zgjedhore për secilën komunë si trupa lokale përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve në komunat përkatëse. Ju, e keni tabelën para jush edhe përmbajtjen e emrave...Këshilli, e rekomandon KQZ që t'i miratojë si të tillë...

Po ashtu, them se, është e vërtetë se ne jemi me një situatë në mes të shpalljes së rezultateve përfundimtare për këto zgjedhje dhe të certifikimit, rrjedhimisht ende si kemi certifikuar rezultatet përfundimtare...Dhe, kjo puna e PZAP-së është e lidhur me dhe e ndërlidhur shumë me zgjedhjet paraprake. Natyrisht se, nuk kemi arritur dhe për mendimi tim do ta kishim përmbyllur këtë proces, por përbërja e KKZ-ve ka mundur t'iu rezultateve aktuale të subjekteve që e kanë kaluar pragun, ndërsa për subjekte tjera qofshin edhe ata anëtarë të koalicionit aktual, të ndiqet edhe të merret për bazë kriteri i shtirjes ose i pjesëmarrjes nëpër komunat konkrete duke i trajtuar në menyre specifike komunat dhe se, do të dilte gjendja e përafërt por, ligjerisht mendoj se do të ishte një vendim më i drejtë...

Betim Gjoshi: Unë po ashtu, kam këto dilema ndoënsë, edhe i kemi diskutuar çështjet në këshill të operacioneve... I kemi para vetes propozimet, unë i përkrahu si të këtilla veç, kisha thanë se në vendim dhe në arsyetim duhet të ketë edhe për bazë neni 67.9 që pavarësisht paragrafëve, i jepë mundësi komisionit zgjedhor me i miratuar KKZ-të ndryshe, dhe të merren parasysh këto që nuk i kemi pas rezultatet e tjera të certifikime pëveç atyre të 2014 sepse, mund të ketë palë të pakënaqura dhe ti shtohet edhe një proces - vendimi për cilin ka pasur edhe si një konsensus që këto komisione komunale zgjedhore, do të gëzon të drejten që ti konfiguroj, pavarësisht që këto subjekte mund ta kenë fatin që të garojnë për zgjedhjet lokale edhe nëse rigrupohen si koalicione...Atëherë, do t'i rikonfigurojë duke ju lejuar vetëm një përfaqësues të një

kualicioni...Tashmë, kuptohet që për raundin e parë, se në të dytin mundet me ndodhë kualicion zyrtar dhe për këtë ne nuk kemi ndonjë interesim...

Bajram Ljatifi: Duhet që, saktësisht çështjet të futen në vendim, prandaj që baza të jetë e saktësuar, dhe ajo të jetë nga zgjedhjet e vitit 2014.

Nenad Rikallo: Edhe pse rezultatet e vitit 2014 kanë qenë ndryshe, përbërja e KKZ në 10 komuna, ka tjetër rezultat sepse, tash ka subjekte politike që atëherë nuk kanë qenë në përbërje të KKZ-ve...Atëherë, nuk kishin mandat, por ja që kanë sot. Vërejtja ime është se, ndonjë subjekt politik favorizohet përtej ligjit. Por, duhet të vendoset kufiri se cak është ligjore, dhe çka nuk është...

Binak Vishaj: Jam për propozimin e këshillit... Pajtohem se, deri sa nuk kemi rezultatet të certifikuara të këtyre zgjedhjeve 2017, ne nuk kemi tjetër zgjidhje...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet e KOZ-it me 2 abstenime.

Për KQZ

Ergit Qeli, anëtar
